



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-70459/25, më 21 MAY 2025

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, dhe nenit 7 të Rregullores 01-020/01-194101 të dt. 08.08.2018, për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, Kryetari i Kryeqytetit, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET caktimi i komisionit për vlerësimin e projekteve për Thirrjen Publike në fushën e kulturës për kategoritë: Festivale, Muzikë, Manifestime, Kinematografi dhe Mbështetje të aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë, për vitin 2025.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, komisioni është në këtë përbërje:
 1. Dafina Krasniqi, Drejtoria e Kulturës, kryesuese;
 2. Lekë Salihu, ekspert i jashtëm, anëtar;
 3. Granit Dragaj, ekspert i jashtëm, anëtar;
 4. Ilir Loshi, Drejtoria e Kulturës, anëtar;
 5. Basrie Pacolli, Drejtoria e Financave, anëtare.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, anëtare rezervë caktohet Drenusha Berisha.
4. Detyrat e komisionit të cekur në pikën 2 të këtij Vendimi, janë të përcaktuara në nenin 8 të Rregullores nr. 01-020/01-194101 të dt. 08.08.2018, për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës.
5. Për kryerjen e detyrave si në pikën 3 të këtij Vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I D O R Ë Z O H E T:

- Drejtorisë së Kulturës;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

